

**BASHKIA KAVAJË**  
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

“Për dhënien me qira me konkurrim publik të pasurisë me nr. 87/2 me indeks harte kadastrale K-34-100-(51-C) e llojit “pa frut” me sip. 105700 m<sup>2</sup> ndodhur në Z.K. 3271 Seferaj, Njësia Administrative Golem”

1.Autoriteti Qiradhënës: Bashkia Kavajë  
Adresa: Rruga “Josif Budo”, Ndërtesa Nr. 10,  
Email: [www.kadastra.bashkiakavaje@gmail.com](mailto:www.kadastra.bashkiakavaje@gmail.com)  
Tel: 055245555

2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja prej 105700 m<sup>2</sup> e pasurisë nr. 87/2, lloji pasurisë “pa frut” pasuri e cila është në pronesi të Bashkisë Kavajë, regjistruar në ASHK-në Kavajë me indeks harte kadastrale K-34-100-(51-C) ndodhur në Z.K. 3271 Seferaj, Njësia Administrative Golem.

3. Qëllimi i dhënies me qira: Pasuria objekt i dhënies me qira do të jepet me qëllim zhvillimin e veprimtarisë bujqësore dhe/ose përdorim blegtoral, sipas objektit të veprimtarisë së subjektit qiramarrës, veprimtari e cila do të gjenerojë të ardhura dhe nxisë punësimin.

4. Afati për dhënien me qira të pasurisë nr. 87/2, lloji pasurisë “pa frut” në ZK 3271 Seferaj, Njësia Administrative Golem, do të jetë 10 (dhjetë) vjet, nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. Vlera dysheme për detyrimin e qirase: 6 000 (gjashtë mijë) lekë/ha për një vit kalendarik.

6. Konkurrimi publik për marrjen me qira do të kryhet në ambientet e Bashkisë Kavajë në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak me datë 28.06.2024 në orën 11:00.

7. Vlerësimi i ofertave të konkurentëve do të bëhet me pikët si më poshtë:

Niveli i investimit	40 pikë
Niveli i punësimit	30 pikë
Çmimi i ofruar (lekë/ha në vit)	30 pikë

8. Subjektet konkurrese duhet të përcjellin dokumentacionin si më poshtë:

- kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore e cila të përmbajë të dhënat e kërkuarit, pasurinë e cila kërkohet të merret me qira e identifikuar me numrat kadastrale përkatës, qëllimin e marrjes në përdorimit të pronës shtetërore
- planbiznes të hollësishëm për përmirësimin e pronës, i cili duhet të përmbajë siglën dhe vulën e administratorit të shoqërisë, në çdo faqe të tij.
- përshkrimin e projektideve të investimit ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, plani i investimit si dhe treguesit që do të realizohen
- ofertën për vlerën e detyrimit vjetor të qirasë
- Deklaratat në formën e vetëdeklarimit ku të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
  - Deklaratë mbi NIPT/NUIS të subjektit kërkuar
  - Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore
  - Deklaratë mbi administratorin dhe subjektin juridik ofertues nëse është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin
- në rastet kur subjekti konkurrese zhvillon aktivitetet me qira ose enfiteozë në objekte pronë shtetërore, të deklarojë shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitetet në objekte shtetërore.

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht skualifikues.

9. Dokumentacion duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për marrje me qira“, dhe i dorëzohen komisionit të shqyrtimit të ofertave, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit.

10. Ofertat dorëzohen nga konkurenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.

11. Data e zhvillimit të konkurrimit: në ambientet e Bashkisë Kavajë, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, me datë 28.06.2024 në orën 11:00.

12. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 28.06.2024 në orën 11:00.